



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja **b**, neni 40, shkronja **I** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 dhe nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, Udhëzimit administrativ nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor, nenit 15, paragrafi 15.1. shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11. 2021, merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR LAGJEN "KALABRIA"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

MIRATOHET Vendimi i Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", 2021-2029.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me miratimin e Planit rregullues të hollësishëm, nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale, me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Kufiri i territorit

Territori që përfshihet nga Plani rregullues i hollësishëm për lagjen "Kalabria", 2021-2029, gjendet në lagjen "Kalabria" dhe përfshinë sipërfaqen rreth $S = 350$ Ha. Ky plan përfshin një pjesë të Zonës kadastrale, Prishtinë dhe një pjesë nga Zona Kadastrale, Çagllavicë.

Neni 5
Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili ka bërë hartimin e Planit rregullues të hollësishëm.

Neni 6
Të tjera

Vendimi përfshinë edhe propozimvendimet e miratuara në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Neni 7
Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë 8-vjeçare.

Neni 8
Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 9
Programi

Pjese e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-245432/21, më 12.11.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

